



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr. 429

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE DHE SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 287 ID, 290 ID, 294
ID, 302 ID, 303 ID, 295 ID, 301 ID, 299 ID, 300 ID, 304 ID, 306 ID, 308 ID, 314 ID, 318 ID, 319 ID, 321
ID, 322ID DHE 324 ID, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE,
PËR PERIUDHËN 14 PRILL – 20 PRILL 2023**

Sot, më datë 3.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Bashkia Sarandë, Bashkia Libohovë.
Z. Astrit Seferkollu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll,
Zj. Rajmonda Shuka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dimal,
Zj. Armela Malaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Mallakastër,
Zj. Rajmonda Zizi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Himarë,
Z. Shefqet Bullari, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Elbasan,
Z. Oltjon Çoba, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Fushë Arrëz,
Z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh,
Z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë,

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023”.

Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër,
Zj. Anisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat,
Z. Florenc Doku, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik.

OBJEKTI: Vlerësimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve si dhe shqyrtimi administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për periudhën 14 prill deri më 20 prill 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregulator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

KREUI

Gjatë periudhës 14 prill deri më 20 prill 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 209 aktivitete nga 51 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se 4 aktivitete të zhvilluara nga 4 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Për aktivitetet e raportuara në tejkalim të afatit ligjor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kryer shqyrtimin administrativ si vijon:

1. **Ministria e Kulturës** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari, përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *“Takim me përfaqësues të artizanatit për të diskutuar rëndësinë e pronësisë intelektuale”*, raportuar në datë 14.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 18.4.2023.

Ministria e Kulturës nëpërmjet email-it të datës 26.4.2023 ka sqaruar se: *Lidhur me aktivitetin “Takim me përfaqësues të Akademisë së Grave Sipërmarrëse për të diskutuar mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale në këtë fushë”, raportuar në datë 14.4.2023, për t’u zhvilluar në datë 18.4.2023, ju informojmë si vijon: Duke qenë së organizimi i këtij aktiviteti ishte impenjativ, pasi kërkohet bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë të së Drejtës së Autorit dhe dy institucioneve të tjera, përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, si dhe pjesëmarrësit, të cilët ishin të ftuar në*

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023”.

këtë aktivitet, ishin artizanë nga e gjithë Shqipëria, ka qenë shumë e vështirë të merrej konfirmimi i tyre në kohë. Organizimi i këtij aktiviteti ka përfunduar në datën 14 prill dhe menjëherë është përcjellë informacioni, sipas kërkesës për të njoftuar KQZ-në. Në konsideratë të parashikimit lidhur me raportimin e veprimtarive publike 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, ju bëjmë me dije se nga ana jonë është njoftuar me përgjegjshmëri ligjore në të njëjtën datë, në të cilën Drejtorisë të së Drejtës së Autorit i është konfirmuar aktiviteti.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, u njoh me rrethanat dhe faktet, dhe rezultojnë se: aktiviteti i raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nuk është me karakter publik, pasi është deklaruar pa pjesëmarrjen e medias dhe publikut. Veprimtaria është e karakterit institucional, me pjesëmarrjen e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit në Ministrinë e Kulturës, Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut të Brendshëm (dy institucione në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë) dhe përfaqësues të artizanatit. Për sa më sipër, vlerësohet se nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

2. **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor, të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Inspektim në terren për ecurinë e punimeve në hapësirën e Auto Moto Park Albania, mbjellja e pemëve dhe prezantimi i kandidatit për Kryetar për Bashkinë Elbasan”*, raportuar në datë 14.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 17.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve dhe nga rrethanat dhe faktet, rezultojnë se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka njoftuar nëpërmjet email-it të datës 15.4.2023 dhe ka sqaruar: *Në vijim të raportimit në ndërfaqen online të KQZ, për eventin e datës 17 prill, ju informojmë se gabimisht (lapsus) është raportuar agjenda politike dhe jo ajo publike. Lutem nga ana juaj, të merret në konsideratë ky email sqarues, pasi për shkak të agjendës së mbingarkuar të ditëve dhe riorganizimit të punëve, ka ndodhur edhe mismatch i agjendave (politike vs. publike).*

Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve, deri ditën e zgjedhjeve.

Në kuptim të tij, nuk raportohen në KQZ veprimtaritë politike/elektorale, si dhe në këto veprimtari, ndalohet pjesëmarrja e nëpunësit dhe funksionarit publik, gjatë orarit zyrtar të punës. Në këto kushte, gjendemi para një lapsusi që ka kryer Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila gabimisht ka raportuar agjendën politike të Drejtorit

të Përgjithshëm, duke marrë parasysh edhe faktin se data e zhvillimit të aktivitetit 17 Prill 2023, ishte pushim zyrtar për të gjithë administratën publike. Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi para kundërvajtjes administrative, për sa kohë që këto aktivitete nuk duhet të raportohen në ndërfaqen e KQZ-së.

3. **Bashkia Sarandë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Dhënie iftari për besimtare mysli-man, të cilët agjërojnë”*, raportuar në datë 14.4.2023 për t’u zhvilluar në datë 18.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve dhe nga rrethanat dhe faktet, vlerëson se aktiviteti i raportuar nga Bashkia Sarandë për shkak të tematikës së cilës i referohet *“Dhënie iftari”*, për shkak dhe të orarit të zhvillimit (ora 20:00), vlerëson se nuk është veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim. Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

4. **Bashkia Libohovë** ka raportuar nëpërmjet në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Homazhe te busti i Avni Rustemit dhe më pas vizitë te shtëpia e tij”*, raportuar në datë 18.4.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 22.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e raportuara në ndërfaqe, faktet dhe rrethanat e tij, rezulton që aktiviteti i raportuar nga Bashkia Libohovë, për shkak të tematikës së cilës i referohet *“Homazhe/Përkujtimore”*, duke marrë parasysh edhe faktin se data e zhvillimit 22 Prill 2023, është ditë e shtunë, pushim zyrtar për administratën publike nuk është veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim. Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi para kundërvajtjes administrative

Kreu II

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 18 (tetëmbëdhjetë) veprimtarive publike, nga 11 (njëmbëdhjetë) institucione publike, për të cilat pretendohet se ka shkelje, sipas kufizimeve të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat *“dh”*, *“f”* dhe *“n”* e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, vijoi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion sqarues në lidhje me veprimtaritë publike të raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Institucionet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

1. Denoncimet e regjistruar me nr. 318 ID, 319 ID, nr. 322 ID dhe 324 ID ndaj bashkisë Berat, për 4 (katër) veprimtari publike për të cilat pretendohet si më poshtë vijon:

- Denoncim regjistruar me nr. **318 ID**, "*Kënaqësi të nisja ditën sot me banorë të Rajonit 3*
Prova link:
[https://www."Facebook".com/ervindemo.al/posts/p"Facebook" id0368ëuqtAu7cG78hDË6f3CKëC7JfSeXqA9Py2tLq21k7rty5yS3mëHsy8USUQKYa6ËI](https://www.)
- Denoncim regjistruar me nr. **319 ID**, "*Me pensionistët e Rajonit 3 të cilët ma ngrohën zemrën me dashamirësinë e tyre për qytetin*
Prova link:
[https://www."Facebook".com/ervindemo.al/posts/p"Facebook" id02GJavCqiUxC6oXvPHj7pprGNT6kddCXatfsVLhYoUoFAStmhxR6YXqt14in3xtEGI](https://www.)
Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

- Denoncimi nr. 322 ID, "Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ në datën 5 prill 2023 se planifikon zhvillimin e aktivitetit me temë "Takim me pensionistë dhe banorë të Nj. Adm. Velabisht" në datën 10 prill 2023. Nga konsultimi i faqes në "Facebook" të kryetarit të bashkisë Berat, vërehet se aktiviteti me këtë temë është postuar në datën 9 Prill 2023. Postimi ka këtë përmbajtje: "Në Velabisht me banorët e zonës me të cilët kemi shumë për të folur duke filluar nga furnizimi me ujë, infrastruktura rrugore apo Urën e Bilçës dhe atë të Gjorovenit. Gjithashtu me lajmin e shumëpritur për asfaltimin e aksit rrugor "VELABISHT-STAROVË-REMANICË-VETERRIK" projekt për të cilin kemi më shumë se 1 vit që punojmë #BashkiaNëPunë"

"Nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarit dhe institucionit përkatës, nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtij aktiviteti. Pra, rezulton se aktiviteti është kryer dhe data e deklaruar për zhvillimin e tij, në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së, ka qenë e plotësuar gabim. Një postim lidhur me zhvillimin e këtij aktiviteti ka bërë edhe Ministri i Brendshëm dhe Drejtuesi Politik i Partisë Socialiste në Qarkun Berat z. Bledi Çuçi. Postimi mban datën 9 prill 2021 dhe shoqërohet me këtë përmbajtje: "Berat- Bashkë me Ervinin në takimin me banorët e Velabishtit çuam edhe lajmin e shumëpritur për rikonstruksionin e rrugës së mezipritur e shumë të domosdoshme për këtë Njësi Administrative. Vota për Ervinin dhe Partinë Socialiste në 14 maj është e vetmja garanci për të vijuar me kantieret e punëve që presin për t'u finalizuar. Njerëzit presin vetëm nga ne sepse nga kundërshtarët tanë ka kohë që s'presin asgjë dhe u kanë hequr vizën.

#MePartinëSocialiste #PërBeratin #MeErvinin "

- **Denoncimi nr. 324** "Më datë 09.04.2023, Bashkia Berat ka zhvilluar një veprimtari publike të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e kqz-së, në datën 05.04.2023. Në këtë aktivitet përpos kryetarit të Bashkisë Berat ka marrë pjesë edhe Ministri i Brendshëm dhe Drejtuesi i Qarkut Berat z. Bledi Çuçi. Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Berat (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes)

"Në Velabisht me banorët e zonës me të cilët kemi shumë për të folur duke filluar nga furnizimi me ujë, infrastruktura rrugore apo Urën e Bilçës dhe atë të Gjorovenit. Gjithashtu me lajmin e shumëpritur për asfaltimin e aksit rrugor "VELABISHT-STAROVË-REMANICË-VETERRIK" projekt për të cilin kemi më shumë se 1 vit që punojmë.

#BashkiaNëPunë

Gjithashtu postim me foto dhe video i këtij aktiviteti (sipas të dhënave si më poshtë) është postuar edhe në faqen në Facebook të z. Bledi Çuçi, Ministër i Brendshëm dhe drejtues politik i Partisë Socialiste në Qarkun Berat: "Faleminderit banorëve të Velabishtit për pritjen dhe mbështetjen që i jepni Partisë Socialiste. Unë besoj se pavarësisht bindjeve, pavarësisht interesave e gjithçkaje tjetër, secili nga ju arrin ta dallojë qartë se ku është e mira, ku është puna dhe ku duhet të shkojë mbështetja. Çdo votë për Ervin Demon!

#MePartinëSocialiste #PërBeratin #MeErvinin "

"Berat- Bashkë me Ervinin në takimin me banorët e Velabishtit çuam edhe lajmin e shumëpritur për rikonstruksionin e rrugës së mezipritur e shumë të domosdoshme për këtë Njësi Administrative.

Vota për Ervinin dhe Partinë Socialiste në 14 maj është e vetmja garanci për të vijuar me kantieret e punëve që presin për t'u finalizuar. Njerëzit presin vetëm nga ne sepse nga kundërshtarët tanë ka kohë që s'presin asgjë dhe u kanë hequr vizën. **#MePartinëSocialiste #PërBeratin #MeErvinin** Ky aktivitet "Takim me pensioniste dhe banore te Nj. Adm. Velabisht" i organizuar nga Bashkia Berat është përdorur haptas dhe qartazi për të kryer diskutime elektorale dhe hedhur premtime të drejtpërdrejta në emër të maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 majit.

Gjithashtu, ndërsa është raportuar që takimi do të zhvillohet më datë 10.04.2023, në të vërtetë ai rezultoi të jetë zhvilluar më përpara, pasi fotot e realizimit të tij janë postuar në datën 09.04.2023 në profilet në Facebook. Konkretisht, Drejtuesi Politik i Partisë Socialiste në Qarkun Berat z. Bledi Çuçi është shprehur:

"Ervinin ka treguar që është një kryetar bashkie i shkëlqyer. Dhe unë jam plotësisht i bindur dhe as nuk lodhem, as nuk e mendoj të lodhem që t'ju bind ju të votoni për Ervinin, sepse jeni ju që i përjetoni të gjitha këto punë publike që ka bërë bashkia. Ne këtë nuk e quajmë thjesht fushatë, e kemi pjesë të komunikimit tonë, pjesë të asaj kontrate që ne kemi bërë me komunitetet.

Jemi dëshmitarë të gjithë që nuk jemi nga ata politikanë që vijnë vetëm një herë në dy vite për t'u parë për fushata elektorale, por jemi vazhdimisht në komunikim me ju për të marrë çdo shqetësim dhe për të adresuar çdo problem që kanë komunitetet, në mënyrë që t'i zgjidhim, në dobi sigurisht tuaj. Edhe këtu në Velabisht janë bërë aq punë nga bashkia sa nuk janë bërë këto 25 vite këtu në Berat, nga çdo lloj qeverie qoftë ajo. Unë skam asnjë dyshim që dhe Velabishti do votojë në masë të madhe Ervinin, dhe skam asnjë dyshim që do të jetë fitore historike për Ervinin. Por ajo që ju kërkoj është që përveç Ervinin, të votojmë edhe listën e këshilltarëve bashkiakë të Partisë Socialiste, sepse është shumë e rëndësishme që këtë radhë Ervinin të ketë mbështetje absolute nga një shumicë e Partisë Socialiste në këshillin bashkiak, që rrugëtimin që kanë nisur ta vazhdojnë bashkë me vendimet që do marrin në këshillin bashkiak.

Prapë e kemi shumë të lehtë, prapë e kemi shumë të lehtë. Shiko çfarë alternative ka opozita. Na ka vënë përballë në këshillin bashkiak të parin në listë njeriun më dështak në Berat, Petritin, që nuk bëri absolutisht asgjë ato 4 vite që ishte kryetar bashkie në Berat."

Fjalimi i plotë në këtë link -Berat- Bashkë me Ervinin në takimin me banorët e Velabishtit çuam edhe lajmin e shumëpritur për rikonstruksionin e rrugës së mezipritur e shumë të... | By Bledi Çuçi | Facebook.

Kryetari i Bashkisë Berat z. Ervin Demo: "(...) Unë ju garantoj që në qoftë se ju keni krijuar bindjen që ne arrijmë të bëjmë disa gjëra, më besoni ne do të bëjmë shumë më tepër këto katër vjet. Dhe urat, dhe rrugët dhe çfarë keni parë nuk janë asgjë me atë çfarë po vjen në Berat. Më lejoni të përmend edhe një gjë tjetër, kush e mendonte para katër vjetësh që ne në Berat do të bënim Urën e Bilshës. Këtu keni qenë të gjithë, as nuk ngrihej si problem, jo problem por as ngrihej si vizion, dukej si ato ëndrrat në sirtar. As kishin guximin ta mendonin banorët e Bilshës. Por ja që ne në Maj fillojmë urën e Bilshës, dhe kjo nuk është një gjë e vogël jo vetëm për banorët e Bilshës, por kjo është një gjë e jashtëzakonshme për gjithë qytetarët e Beratit, sepse ai është një projekt strategjik nga pikëpamja e zhvillimit të qytetit."

Vlen të theksohet se nga konsultimi i raportimit të Bashkisë Berat në ndërfaqe për këtë aktivitet, rezulton se aktiviteti është publik, i hapur për pjesëmarrjen e medias dhe publikun, si dhe se do të marrin pjesë vetëm: Kryetari i Bashkisë, Drejtore e Drejtorisë së Turizmit dhe Aktiviteteve.

Ndërkohë që aty konstatohet se morrën pjesë edhe z. Bledi Çuçi, udhëheqës politik i Qarkut Berat, deputeti Fadil Nasufi, etj".

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Berat:

Më datë 17.4.2023, bashkisë Berat i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, për denoncimet të regjistruar me nr. 318 ID, 319 ID, nr. 322 ID dhe 324 ID nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 21.4.2023, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat ndër të tjera bën me dije se:

Në lidhje me denoncimet nr. 318 ID dhe nr. 319 ID: "Bashkia Berat e ka raportuar takimin e mbajtur me pensionistët dhe banorë të Rajonit nr. 3, në Berat dhe pikërisht në lagjen "Uznovë", që është pjesë përbërëse e këtij rajoni administrativ.

Të dhënat e raportimit kanë qenë si më poshtë:

Takim me banorë të lagjes "Uznovë"

Bashkia Berat | 02/04/23

Takim me pensionistë të lagjes Uznovë, me gratë e zonës, me qytetarë përfitues të bonusit të rikonstruksionit, banorë të zonës "Cekin", ku janë kryer punime në infrastrukturën rrugore, etj.

Lloji i Aktivitetit: Këshillim; Data: 07/04/2023; Ora: 12:00; Vendi i Zhvillimit: Lagjja "Uznovë"; Shteti: Shqipëri; Qarku: Berat; Bashkia: Berat; Njësia Administrative: Rajoni nr. 3; Folësit kryesorë: Kryetari i Bashkisë; Pozicioni: Titullari i Bashkisë; Pjesëmarrësit: Kryetari i Bashkisë, Drejtore e Drejtorisë së Turizmit dhe Aktiviteteve etj.; Me pjesëmarrjen e medias: Po

I hapur për publikun: Po; Personi përgjegjës për raportim: Gentian Dashi; Personi i ngarkuar nga ligji për raportim; Arisa Toska.

Një pjesë e takimeve të zhvilluara më datë 07.04.2023, pikërisht ai i realizuar në lagjen "Donika Kastrioti", që po ashtu është pjesë administrative e Rajonit nr. 3, është pasqyruar në faqen e "Facebook" më datë 07.04.2023, ndërsa pjesa tjetër e takimeve të zhvilluara po në këtë datë është pasqyruar më datë 13.04.2023. Por, theksojmë se takimet janë realizuar brenda një dite dhe pikërisht më datë 07.04.2023, pavarësisht se një pjesë e këtyre takimeve është pasqyruar në ditët e mëvonshme në faqen e "Facebook" të z. Ervin Demo. Theksojmë se raportimet pranë KQZ për aktivitetet që realizohen, sipas leqislacionit në fuqi, kanë për qëllim të informojnë publikun për ditën se kur ato zhvillohen (për t'i dhënë mundësi atyre të marrin pjesë në to) dhe jo për afatet se kur mund të publikohen në faqet elektronike ku ato pasqyrohen ato mund të pasqyrohen edhe në ditë të mëvonshme se ajo kur realizohen, për këtë detaj nuk ka ndonjë detyrim liqor që duhet respektuar."

Në lidhje me denoncimet me nr. 322 ID dhe nr. 324 ID: "Bashkia Berat ka raportuar më datë 05.04.2023, mbi një takim me pensionistë dhe banorë të Njesisë Administrative Velabisht, që

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023".

ishte planifikuar të mbahej më datë 10.04.2023. Ky takim i planifikuar të mbahej më datë 10.04.2023 nuk është zhvilluar. Arsyeja e moszhvillimit të takimit të raportuar më datë 10.04.2023 ishte pasi në agjendën politike të Drejtuesit Politik të Partisë Socialiste të Qarkut të Beratit z. Bledi Çuçi dhe Kandidadit të Partisë Socialiste z. Ervin Demo ishte planifikuar të organizohej një takim me karakter elektoral në Njësinë Administrative Velabisht. Në përmbajtjen e tyre dhe në tërësinë e problematikave që do të prekeshin në këto takime (PRA takimit të organizuar nga Partia Socialiste Dega Berat së bashku me Drejtuesin Politik të Qarkut Berat dhe Kandidatin e Partisë Socialiste të datës 09.04.2023 NGA NJËRA ANË dhe takimit të organizuar nga Bashkia Berat të datës 10.04.2023 nga ana tjetër) kishte shumë pika të përbashkëta ku një pjesë e mirë e tyre u prekën dhe u ezauruan në takimin elektoral të organizuar nga Partia Socialiste Berat më datë 09.04.2023, prandaj meqenëse agjendat e Kandidatit të Partisë Socialiste z. Ervin Demo (ajo elektorale si kandidat dhe ajo zyrtare në kuadër të detyrës së tij aktuale si Kryetar Bashkie) janë shumë të ngjeshura dhe me shumë pak hapësira, u mendua që takimi i planifikuar të organizohej nga Bashkia Berat një ditë më pas, të anulohet dhe të mos zhvillohet. Theksojmë se në takimin e datës 09.04.2023 nuk ka patur pjesëmarrës nga stafi i Bashkisë Berat duke respektuar detyrimet ligjore sipas Kodit Zgjedhor, pasi ky takim ka qenë me karakter politik dhe elektoral”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e bashkisë Berat. Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por palët nuk u paraqitën në seancën publike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, vlerësoj se:

Në lidhje me denoncimet me nr. 318 ID dhe nr. 319 ID, Bashkia Berat, në datën 2.4.2023 ka raportuar kryerjen e një aktiviteti në datën 7.4.2023. Tematika e këtij takimi ka qenë “Takim me pensionistë të lagjes Uznovë, me gratë e zonës, me qytetarë përfitues të bonusit të rikonstruksionit, banorë të zonës “Çekin”, ku janë kryer punime në infrastrukturën rrugore, etj.” Ndërfaqja e raportimeve, është krijuar me qëllim informimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi zhvillimin e aktivitetit, si dhe vlerësim e veprimtarisë si të lejuar për tu zhvilluar, ose jo. Vlerësohet e rëndësishme të sqarohet se, **aktivitetet e kryera nga institucioni duhet të raportohen të ndara dhe veçmas, në mënyrë që qartazi të identifikohen elementët e domosdoshëm të raportimit. Në rastet kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kërkon monitorimin e këtij aktiviteti, e ka të pamundur ushtrimin e kësaj detyre dhe të drejte, që i ngarkohet nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Megjithatë, të ndodhur në kushtet që aktivitetet janë kryer dhe nga hetimi nuk u arrit të provohej keqpërdorim i burimeve publike, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ dhe ti tërhiqet vëmendja personit përgjegjës për raportim në bashkinë Berat, për përmbushjen e këtij detyrimi sipas kërkesave të dispozitave ligjore.**

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023”.

Në lidhje me denoncimet me nr. 322 ID dhe nr. 324 ID, në përfundim të hetimit administrativ, pasi u shqyrtuan materialet e **denoncimeve nr. 322 ID dhe nr. 324 ID për bashkinë Berat**, u vlerësua se natyra e aktivitetit të kryer nga kryetari është i karakterit politik/elektoral. Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të aktiviteteve me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kryetari i bashkisë si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta.

Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se, *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”*, vlerësojmë se aktiviteti i kryer nuk ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi nuk janë organizuar dhe zhvilluar nga institucioni i bashkisë.

Bashkia Berat ka raportuar kryerjen e një aktiviteti, i cili nuk është zhvilluar për shkak të ndryshimit të agjendës. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve inkurajon institucionet publike, të cilat vërejnë se kanë bërë gabime materiale në raportimin e aktivitetit apo kanë ndryshim agjende dhe nuk mund ta kryejnë aktivitetin, sipas të dhënave të raportuara, në çdo kohë duhet të venë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili vlerëson nëse aktiviteti i raportuar, mund të zhvillohet apo jo. Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi **me nr. 322 ID dhe 324 ID**, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3 dhe 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2. Denoncimi i regjistruar me nr. 321 ID, ndaj Bashkisë Cërrik, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncim regjistruar nr. **321 ID**, *“Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ në datën 10 Prill 2023, se planifikon zhvillimin e aktivitetit me temë “Inspektim në kantierin e infrastrukturës publike” në datën 15 Prill 2023. Nga konsultimi i faqes në “Facebook” të Bashkisë Cërrik, vërehet se aktiviteti me këtë temë është postuar në datën 8 Prill 2023.*

Postimi ka këtë përmbajtje:

“LINAS Në lagjen e Dymave po vazhdojmë punimet për rehabilitimin e rrugëve të kësaj lagje, për të krijuar lehtësimin e lëvizjes së banorëve të kësaj lagje, jo vetëm në banesat por edhe në tokat e tyre bujqësore.

#BashkiaCërrik #NëShërbimTëBanorëve”

Nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarit dhe institucionit përkatës, nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023”.

Pra, rezulton se aktiviteti është kryer dhe data e deklaruar për zhvillimin e tij, në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së, ka qenë e plotësuar gabim”.

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Cërrik:

Më datë 17.4.2023, bashkisë Cërrik i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 18.4.2023, personi përgjegjës për komunikimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për bashkinë Cërrik, ndër të tjera bën me dije se *“Në datë 8 Prill është publikuar në “Facebook”, aktiviteti publik i kryer në datë 7 Pril, l në fshatin Linas, Nja. Mollas rruga e Dyrmave. Për rastin konkret kemi raportuar në ndërfaqen e aktiviteteve në datë 2 Prill me emërtimin “Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike Linas.” Për të cilën është njoftuar zhvillimi i aktivitetit në datë 7 Prill ora 11.00, dhe është pasqyruar në “Facebook” të nesërmen në datë 8 Prill.”*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqitën në seancën publike.

Në përfundim të shqyrtimit administrative vlerësoj se:

nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Cërrik, referuar denoncimit nr. **321 ID**, ka përmbushur detyrimin për raportim të parashikuar nga neni 92 i Kodit Zgjedhor, brenda afateve ligjore.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për këtë denoncim nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

3. Denoncimi i regjistruar me nr. 314 ID ndaj Bashkisë Shkodër, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 314 ID** *“Shkodra duhet dhe do të jetë një pol i rëndësishëm për të gjithë rajonin! Ajo që po ndodh sot është emergjente të ndryshohet dhe prandaj thellimi i bashkëpunimit me universitetin “Luigj Gurakuqi” do të jetë një prej prioriteteve të punës tonë. Zhvillimi i qytetit dhe shfrytëzimi i potencialeve që kanë të rinjtë, duke krijuar më shumë mundësi dhe hapësira angazhimi për studentët mbetet sfida kryesore. Gjatë bashkëbisedimit me pedagogët e universitetit, shkëmbyem ide dhe analizuam pika të programit për arsimin. Duke i falënderuar për kontributin që japin dhe sugjerimet që më parashtruan, i ftova të jenë partner të këtij rrugëtimi që Shkodra si qytet universitar, të rikthehet aty ku e ka vendin në arsimin e lartë. Jam i lumtur që si pjesë të listës së kandidatëve për këshillin bashkiak, kemi një grup*

pedagogësh ekspertë të fushave të ndryshme që kam bindjen se do të jenë një zë konstruktiv në parlamentin e qytetit.

#14MajvotoBardhSpahia #Ndryshiminëduarttua #Bashkefitojmë

Prova link:

[https://www."Facebook".com/bardhspahia/posts/p"Facebook" id08RCiMkxJEfVSHsp6CM9U PYsYTzeËATES8xpBRiBcVqRjëXnTYxmDPFnKBHCkuvËfl](https://www.)".

Më datë 17.4.2023, bashkisë Shkodër i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 18.4.2023, ka sqaruar se: *"Ju informojmë se aktiviteti i raportuar është një aktivitet i zhvilluar me pjesëmarrjen e z. Bardh Spahia dhe është publikuar vetëm në rrjetin social "FACEBOOK", në adresën personale"*.

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Shkodër:

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqitën në seancën publike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ vlerësoj se:

Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve, rezultoi se: Referuar pikës 1, të nenin 92 të Kodit Zgjedhor *"Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre"* detyrimi për raportim rëndon vetëm mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore. Referuar të dhënave të denoncimeve të regjistruara me nr. 314 ID, u vlerësua së aktiviteti i mësipërm nuk është aktivitet institucional dhe si i tillë nuk duhej të raportohet.

Postimet në llogaritë personale në rrjetin social "Facebook" të kryetarëve të bashkisë, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Kryetari i bashkisë është organ me karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit. Takimet personale të z. Spahia apo postimet në llogaritë personale në rrjetin social "Facebook" të kryetarit të bashkisë, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objektit të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kryetarët e bashkive nuk zhvishen nga e drejta e tyre private për të shprehur lirshëm bindjet politike, apo për të zhvilluar takime elektorale, për aq kohë

sa nuk përdorin burime publike për kryerjen e tyre. Të ndodhur në këto kushte, vlerësoj se veprimtaritë e mësipërme, nuk janë veprimtari që kanë pasur detyrimin për raportim pasi janë veprimtari personale të kryetarit të bashkisë dhe jo të bashkisë Shkodër.

4. Denoncimi regjistruar me nr. 287 ID ndaj Bashkisë Devoll, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **287 ID** " Përmirësimi i infrastrukturës dhe uji i pishëm 24 orë në Vidohovë nuk ishin zotime, por një detyrë që fatkeqësisht nuk ishte mbajtur në 30 vjet duke i lënë banorët në pritje me sy nga titullarë që iknin dhe vinin me duar në xhepa. Për këtë s'ka asnjë dyshim por ka veç vizion, vullnet dhe forcë, për, #DevollinQëDuam #DevollinQëNukNdalet "

Prova link:

[https://www."Facebook".com/eduard.duro.5/posts/p"Facebook" id0P1h1UduS2VtEGyTxjKJmEKAMh2T4nHjS9zGVzYjXi4m19v1BHFRFuËUrahGhfCmCl](https://www.)

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 17.4.2023, bashkisë Devoll i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 18.4.2023 jemi informuar se: "Ky takim nuk është veprimtari publike e organizuara nga institucioni jonë për këtë arsye nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-se, pasi ne si institucion nuk kemi qenë organizator i këtyre takimeve. Ky takim është organizuar pas orarit zyrtar dhe është veprimtari politike /Elektorale e organizuar në fshatin Vidohovë të bashkisë Devoll ku është lehtësisht e dukshme që dhe organizimi është bërë në ambiente private dhe jo publike apo ambiente në varësi të bashkisë Devoll, ku sipas udhëzimit tuaj nuk raportohen në KQZ. Në zhvillimin e këtyre veprimtarive nuk ka pasur përdorim të burimeve publike, nuk ka pasur asnjë logo, apo simbole të ngjashme të institucioneve publike, nuk ka pasur pasqyrim të asnjërës prej këtyre veprimtarive në faqet zyrtare (ëeb, "Facebook", etj) të bashkisë e cila mund të verifikohet lehtësisht nga ana juaj, apo të jenë publikuar në profilin zyrtar të kryetarit të bashkisë Devoll. Këto aktivitete ashtu sikurse juve keni paraqitur edhe linkun në e-mail janë të pasqyruara vetëm në profilin personal (jo zyrtar) të Kryetarit të bashkisë Devoll. Pra kandidati mund të pasqyrojë pjesëmarrjen në rrjete sociale private që ai përdor për fushatë, por jo në faqen e bashkisë Devoll.

Theksojmë që nuk kanë qenë takime në lidhje me inagurime të zhvilluara në kuadër të veprimtarive politike. Pra në përfundim sqarojmë se kjo veprimtari politike/elektorale nuk është veprimtari me karakter institucional për të cilën sipas udhëzimeve tuaja, ne duhet të bënim raportimin në KQZ, bashkia ka detyrimin të raportojë në K.Q.Z vetëm aktivitete publike ku bashkia është organizatore, dhe jo aktivitete publike ku kryetari merr pjesë si kandidat-figurë politike. Kryetari i bashkisë ndjek agjendën e tij si kandidat dhe figurë politike dhe kjo agjendë nuk përfshihet në raportimet e aktiviteteve të bashkisë Devoll, sipas Kodit Zgjedhor."
Hetimi administrativ ndaj bashkisë Devoll:

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqitën në seancën publike.

5. Denoncimi regjistruar me nr. 290 ID ndaj Bashkisë Dimal, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **290 ID** *"Një takim i frytshëm me komunitetin në Syzes, ku folëm për punët e mira që kemi bërë, si dhe shumë të tjera që do të pasojnë. Jam shumë e lumtur që disa ditë më parë nisi puna për rrugën e re që lidh Syzesin me Malas-Gropë"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/MemajJuliana/posts/pfbid0RuKz5jRV5KRBaXiDp6CVACNoBcaeu5fXHJkNrMeDug7NmTAiHEygz3HcHHMTKXAI>

Më datë 17.4.2023, bashkisë Dimal i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 21.4.2023 jemi informuar se: *"Bashkia ka për detyrim që të raportojë në KQZ, vetëm ato aktivitete publike, ku bashkia është organizatore dhe jo aktivitetet politike, ku kryetari merr pjese si kandidat-figurë politike. Aktiviteti për të cilën referoheni se nuk është raportuar, nuk është aktivitet i organizuar nga bashkia Dimal, por është aktivitet politik i organizuar nga kryetarja e bashkisë Dimal, në cilesinë e kandidatit -figurë politike, dhe si i tillë është publikuar në faqen e saj personale".*

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Dimal:

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë publike u paraqit, pëfaqësuesi me autorizim i bashkisë Dimal, ku u pretendua se aktiviteti është i karakterit politik dhe si i i tillë, bashkia nuk ka pasur detyrimin për të raportuar.

6. Denoncimet regjistruar me nr. 294, 302, 303 ID ndaj Bashkisë Belsh, për 3 (tre) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **294 ID** "Me Njerëzit për Njerezit- Bashkëbisedim me banorët Gjolenës ku diskutuam mbi projektet e 4-vjeçarit të ardhshëm.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim"

Prova link:

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023".

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0GGVxGgSic877QZKK5YoN9EhroTDks7bRRlrihy1iRrtxpQVqSY2dk9oQzy14SgV6l&id=100063701572345

- **Denoncimi nr. 302 ID** "E nisëm bashkëbisedimin nga Rrasa e Poshtme, ku mbështetja për PS nuk ka munguar asnjëherë. Ecim përpara deri në përfundimin e projekteve të filluara, si edhe atyre që kemi gati. Kurrë pas, PËRPARA!"

Prova link:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0ne4MUUgMNjMjMRëvyY5rpe3GmaxxNDtL3afYb5Ëjex99kAJZe5HqBt2y5Ë7Ua3ml&id=100063701572345

- **Denoncimi nr. 303 ID** "Në fshatin Lisaj, ku morëm një mesazh të qartë të mbështetjes për 14 Majin. #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa #KrenarpërPS"

Prova link:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02R2erzUKtszJKkjPq7f1GNP99P87VdGjZd5zNMDR5pkNoRkYc5qSV7AfaNZoehFV9l&id=100063701572345

Më datë 17.4.2023, bashkisë Belsh i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë.

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Belsh:

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e bashkisë Belsh.

7. Denoncimi regjistruar me nr. 300 ID ndaj Bashkisë Elbasan, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 300 ID** "Kënaqësi të isha sot në Balëz në një bashkëbisedim të sinqertë e të hapur. Detyra jonë është të takojmë sa më shumë qytetarë derë më derë, njësoj siç kemi bërë gjatë gjithë këtyre viteve. Të bisedojmë me ta për bilancin e punëve të kryera, çka mund të përmirësojmë në punën tonë dhe ato që do të bëjmë në 4 vitet e ardhshme. #ElbasaniNukNdalet".

Prova link:

<https://fb.watch/jU2dmlq2tY>

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Elbasan:

Më datë 17.4.2023, bashkisë Elbasan i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë.

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023".

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e bashkisë Elbasan.

8. Denoncimi regjistruar me nr. 299 ID ndaj Bashkisë Himarë, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 299 ID**, ku pretendohet se: *"Këtë pasdite, një falenderim i singertë shkon për të gjithë banorët e fshatit Pilur, të cilët jetojnë e punojnë prej vitesh në Greqi. Mbështetja juaj e pakursyer në gjithë këto vite, ka qenë një shtysë shumë e madhe për Partinë Socialiste dhe personalisht personin tim, për t'u dedikuar ndaj problematikave të ndryshme që ka komuniteti i banorëve të Pilurit, dhe jo vetëm. Natyrisht, një prej fshatrave padyshim nga më të rrallët për nga bukuria të Rivierës Shqiptare, që përpos investimeve të realizuara për transformimin e tij, gjejmë motivim për të bërë akoma edhe me shumë për Pilurin dhe gjithë Qendrat e Banuara të Bashkia Himarë. Me mirënjohje, Goro. #ritminukndalet #punëpërhimarëntonë #himaranesër"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/JorgoGoro/posts/pfbid02zCëFSiPvbFrxrDVocAEëx27dVnVHYr15xbavN698u9X9ËfZfSmf8pkA9sAUcPm2HI>

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Himarë:

Më datë 17.4.2023, bashkisë Himarë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e mara, nëpërmjet adresës elektronike por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e bashkisë Himarë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ ndaj bashkisë Devoll, Dimal, Belsh, Elbasan, Himarë vlerësoj se:

Natyra e aktiviteteve të kryera nga kryetarët janë të karakterit politik/elektoral. Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të aktiviteteve me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kryetari i bashkisë, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta.

Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se, *"Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve"*, vlerësojmë se aktiviteti i kryer nuk ka pasur detyrimin

për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi nuk janë organizuar dhe zhvilluar nga institucioni i bashkisë.

Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi regjistruar **me nr. 287 ID, 290 ID , 294 ID, 302 ID, 303 ID, 300 ID, 299 ID**, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3 dhe 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

9. Denoncimet regjistruar me nr. 295 ID, 301 ID ndaj Bashkisë Mallakastër, për 2 (dy) veprimtari publike, për të cilat pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 295 ID:** "Mallakastër-Me kryetarin e bashkisë Qerim Ismailaj Mallakastër Me kryetarin e bashkisë Qerim Ismailaj pamë nga afër punën që po kryhet për rikonstruksionin e Muzeut të qytetit të #Ballshit.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonëAL"

Prova link:

<https://www.facebook.com/b.taulant/videos/592198709604100/>

- **Denoncimi nr. 301 ID** "Me kryetarin e bashkisë Qerim Ismailaj pamë nga afër punimet që po kryhen për rikonstruksionin dhe asfaltimin e disa rrugëve të fshatit #Dukas. Premtim i mbajtur. #ShqipëriaEArdhmjaJonë #TëBashkuarJoTëNdarë"

Prova link:

<https://www.facebook.com/b.taulant/videos/635465855084907/>

Më datë 17.4.2023, bashkisë Mallakastër i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë.

Hetimi administrativ ndaj Bashkisë Mallakastër:

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e bashkisë Mallakastër.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ vlerësoj se:

Pasi u shqyrtuan pamjet filmike, provat dhe faktet, vlerësoj se veprimtaritë e kryera nuk përbëjnë veprimtari të ndaluara në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Vlerësoj se kryetari i bashkisë ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale. Nga këqyrja e materialeve, nuk rezulton që në këtë aktivitet janë mbajtur deklarime apo thirrje elektorale nga asnjë prej pjesëmarrësve. Pjesëmarrja e deputetit jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektorale. Fjalimi me përmbajte elektorale, logot, materialet

propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë.

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.199, "Statusi i Deputetit", deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Mallakastër nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

10. Denoncimi regjistruar me nr. 304 ID ndaj Bashkisë Fushë Arrëz, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 304 ID**, "Para pak ditësh, në mjediset e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, u zhvillua ceremonia solemne e dorëzimit të titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes), familjarëve të z. Muhamet Hysen Saliko".

Prova link:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0G16rjLfbYjb7yzAghf5tjtsvmUtegSUHfep3DXvDyg5SbpuyXNH8pT5ërVfjt1jul&id=100090668141729

Hetimi administrativ ndaj bashkisë Fushë Arrëz:

Më datë 17.4.2023, bashkisë Fushë Arrëz i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Përfaqësuesi i me autorizim i bashkisë Fushë-Arrëz, gjatë seancës tha se aktiviteti i mësipërm është kërkuar nga familjarët dhe bashkia Fushë Arrëz do jetë me e kujdesshme me përmbushjen e këtij detyrimi.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ vlerësoj se:

Për shkak të tematikës dhe natyrës së së veprimtarisë së kryer, vlerësojmë institucioni publik nuk ka pasur detyrimin për raportim. Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për bashkinë Fushë-Arrëz pasi nuk përmban rrethana që mund të përfshihen në parashikimet e neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor.

11. Denoncimet regjistruar me nr. 306 dhe nr. 308 ID ndaj Bashkisë Tiranë, për 2 (dy) veprimtari publike, për të cilat pas verifikimeve rezultojnë e njëjta veprimtari, për të cilën pretendohet si vijon:

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023".

- **Denoncimi nr. 306 dhe 308 ID**, ku pretendohet se: *“Xhami e re “Mahmut Vrapit”, te Njësia nr. 2 . Ta gëzoni!”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/ErionVeliaj/posts/pfbid02EHQncj4zdcpAH5öp7mEB11ZvDZgvëE DF7fgYx1Km6Vdkydudy79jDLUzGryGGoel>

Hetimi administrativ ndaj Bashkisë Tiranë:

Më datë 17.4.2023, bashkisë Tiranë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike por provohet që personi përgjegjës për komunikimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për bashkinë Tiranë, nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për informacion.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por pala në proces hetimi administrativ nuk u paraqit.

Në përfundim të seancës, bashkia Tiranë na ka informuar se *“Në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana juaj për sa i përket denoncimit për aktivitetin e inaugurimit të Xhamisë “Mahmut Vrapit”, në njësinë nr. 2, ju bëjmë me dije se kjo veprimtari është organizuar nga Komuniteti Mysliman dhe jo nga bashkia Tiranë”.*

Në përfundim të shqyrtimit administrativ vlerësoj se:

Referuar provave të paraqitura nga ana e bashkisë Tiranë, rezultoi se organizatori i takimit ka qenë Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Pjesëmarrja e z. Veliaj në këtë aktivitet ka qenë në cilësinë e të ftuarit. Referuar nenit 4, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator përcakton se *“Struktura përkatëse e teknologjisë së informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mundëson akses të personalizuar në këtë ndërfaqe për të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij vendimi, me qëllim që të hedhin të dhënat për institucionin që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë”*, detyrimi për raportim bie mbi institucionin organizator të aktivitetit.

Për sa më sipër, referuar nenit 92, pika 3 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 4, pika 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për personin përgjegjës për raportim në bashkinë Tiranë, pasi nuk u arrit të provohej shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Data: 3.5.2023 Nr. 429
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 Prill – 20 Prill 2023”.

Bazuar në nenet 19 pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOS:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative për raportimet e kryera në shkelje të afatit ligjor
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Ministria e Kulturës,
 - b) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor,
 - c) Bashkia Sarandë,
 - ç) Bashkia Libohovë.
3. Pushimin e procedimit administrativ për denoncimet me nr. 287 ID, 290 ID, 294 ID, 302 ID, 303 ID, 295 ID, 301 ID, 299 ID, 300 ID, 304 ID, 306 ID, 308 ID, 314 ID, 318 ID, 319 ID, 321 ID, 322 ID dhe 324 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj:
 - Z. Astrit Seferkollli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll,
 - Zj. Rajmonda Shuka person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dimal,
 - Zj. Armela Malaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Mallakastër,
 - Zj. Rajmonda Zizi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Himarë,
 - Z. Shefqet Bullari, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Elbasan,
 - Z. Oltjon Çoba, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Fushë Arrëz,
 - Z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh,
 - Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër,
 - Zj. Anisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat,
 - Z. Florenc Doku, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik,

- z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë.
- 4. Ky vendim t'u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
- 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI